

OLIMPIADA E EKONOMIKSIT 2026 – TESTI I RAUNDIT RAJONAL

Emri dhe mbiemri _____ Shkolla/qyteti _____

Totali i pikëve _____

Udhëzime për testin:

Mirë se vini në Raundin Rajonal të Olimpiadës së Ekonomiksit!

Përmbajtja: Ju lutemi lexoni me kujdes udhëzimet e testit. Testi është i ndarë në katër pjesë:

- Pjesa I - Pyetje me zgjedhje të shumëfishta: në këtë pjesë të testit, duhet të zgjidhni vetëm një përgjigje të saktë.
- Pjesa II - Pyetje të Hapura: Jepni përgjigje për pyetjet e dhëna.
- Pjesa III - Pyetje me grafikun: Në këtë pjesë duhet të analizoni grafikun e paraqitur dhe t'u përgjigjeni pyetjeve të paraqitura duke interpretuar grafikun.
- Pjesa IV - Ese: Në këtë pjesë ju jepet ese dhe duhet të jepni përgjigje për pyetjen në formatin e esesë. Ju lutemi shkruani qartë dhe të jeni konciz në përmbajtje duke përdorur njohuritë tuaja personale dhe origjinale.

Kohëzgjatja: Testi zgjat 2 orë. Gjatë testit, përdorimi i telefonave dhe komunikimi në çdo formë me kolegët ose qasja në pajisjet teknologjike (telefon, tablet dhe kompjuter) është i ndaluar.

Kopjimi dhe plagjiatura: Në rast të kopjimit ose plagjiaturës së çfarëdo lloji, do të largoheni nga testi dhe të skualifikoheni nga garat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për çdo pyetje ose pasiguri gjatë testit, ju lutemi ngrini dorën dhe një nga profesorët e testit do t'ju ndihmojë.

Deklaratë pëlqimi për përdorimin e të dhënave personale (GDPR)

- Pajtohem që të dhënat e mia personale (emri, mbiemri) do të përdoren vetëm për qëllime identifikimi gjatë testimit nga profesorët, por jo nga palë të treta. ☐
- Pajtohem që fotot dhe videot nga kjo garë do të përdoren për qëllime promovimi të konkursit dhe si material marketingu për kanalet zyrtare të EFI NM dhe LAI. ☐

Ju urojmë suksese!

PJESA 1 – PYETJE ME ZGJEDHJE TË SHUMËFISHTA (10 x 2 pikë = 20 pikë)

1. Cila nga të mëposhtmet shpesh quhet postulati bazë i ekonomisë?
 - a) Individët veprojnë vetëm nga motive egoiste.
 - b) Stimujt kanë rëndësi; individët reagojnë në mënyra të parashikueshme ndaj ndryshimeve në kostot dhe përfitimet personale.
 - c) Saktësia e supozimeve është testi më i mirë i një teorie ekonomike.
 - d) Vlera e një malli është objektive; është e barabartë me koston e prodhimit të mallit..
2. Nëse një vend, biznes ose person ka një avantazh krahasues në prodhimin e një malli ose shërbimi, kjo do të thotë që ky vend, biznes ose person:
 - a) mund ta prodhojë këtë mall ose shërbim me një kosto të lartë oportune.
 - b) duhet ta blejë këtë mall nga të tjerët.
 - c) mund ta prodhojë këtë mall ose shërbim me një kosto të ulët oportune.
 - d) mund ta prodhojë këtë mall me të njëjtën kosto oportune si të tjerët.
3. Cila nga alternativat e mëposhtme ka shumë të ngjarë të zhvendosë kurbën e ofertës majtas për laptopët?
 - a) një rritje në çmimin e laptopëve.
 - b) një rënie në çmimin e çipave kompjuterikë të përdorur për të prodhuar laptopët.
 - c) një rënie në kërkesën për laptopët.
 - d) një rritje në çmimin e komponentëve elektronikë të përdorur për të prodhuar laptopë.
4. Kur një qeveri pengon një shkëmbim vullnetar midis një konsumatori dhe prodhuesit?
 - a) konsumatori është në një pozitë më të mirë, por prodhuesi është në një pozitë më të keqe.
 - b) të dyja palët në shkëmbimin potencial janë në një pozitë më të keqe nga ç'do të kishin qenë nëse tregtia do të ishte lejuar.
 - c) mallrat lëvizin nga njerëzit që i vlerësojnë më pak tek njerëzit që i vlerësojnë më shumë.
 - d) si konsumatorët ashtu edhe prodhuesit janë në një pozitë më të mirë..
5. Vendimi i prodhuesit për të drejtuar burimet në prodhimin e një malli ose shërbimi do të jetë fitimprurës kur:
 - a) konsumatorët janë të gatshëm të paguajnë një çmim më të madh se kostoja për njësi të prodhimit.
 - b) prodhimi subvencionohet nga qeveria.
 - c) prodhuesit në vende të tjera mund ta prodhojnë mallin ose shërbimin me një kosto më të ulët.
 - d) normat e interesit janë të larta dhe tregjet janë të buta.
6. Çfarë i bën paratë të vlefshme?
 - a) Mbështetet nga ari dhe argjendi.
 - b) Mbështetet nga obligacionet e thesarit të SHBA-së.
 - c) Emetohet nga kompanitë e kartave të kreditit si American Express, MasterCard dhe Visa.
 - d) Shërben si mjet këmbimi, njësi llogarie dhe ruajtës vlere..
7. Deficitet buxhetore janë tërheqëse për politikanët për shkak se deficitet:
 - a) e bëjnë të mundur ofrimin e përfitimeve për votuesit pa pasur nevojë të vendosin taksa përkatëse.
 - b) normalisht kompensohen nga tepricat e mëparshme buxhetore.
 - c) i bëjnë kostot e qeverisë më të dukshme për votuesit sesa taksimi aktual.
 - d) i mundësojnë qeverisë të punësojë burime pa pasur kosto.
8. Kur veprimet e një personi ose grupi personash shkojnë drejt dëmtimit ose përfitimit të një grupi tjetër pa pëlqimin e tyre, kjo njihet si:
 - a) monopol.
 - b) eksternalie.
 - c) dështimi i qeverisë.
 - d) ligji i kërkesës.

9. Cila nga pohimet e mëposhtme është e vërtetë në lidhje me tatimet dhe subvencionet?
 - a) Politikanët pëlqejnë të vendosin tatime, por ngurrojnë të subvencionojnë aktivitetet.
 - b) Si tatimet ashtu edhe subvencionet rrisin nxitjen për të punuar dhe për të përdorur burimet në mënyrë efikase.
 - c) Nëse tatimoni diçka, do të merrni më pak prej saj; nëse subvenciononi një aktivitet, do të merrni më shumë prej saj.
 - d) Nëse tatimoni diçka, do të merrni më shumë prej saj; nëse subvenciononi një aktivitet, do të merrni më pak prej saj.
10. Cila nga pohimet e mëposhtme është më e rëndësishme për të rinjtë që duan të rrisin pasurinë e tyre dhe të përmirësojnë standardin e jetesës me kalimin e kohës?
 - a) Shpenzimi i të gjitha të ardhurave të tyre aktuale për mallra dhe shërbime të konsumit.
 - b) Përdorimi i gjerë i kartave të kreditit për të blerë artikujt e nevojshëm.
 - c) Blerja e një makine të re të paktën çdo dy vjet.
 - d) Kursimi dhe investimi i rregullt i një pjese të të ardhurave të tyre.

1. Çfarë paraqet recesioni dhe si manifestohet ai?
2. Si e përcaktoni paritetin e fuqisë blerëse (purchasing power parity)?
3. Cili është ndryshimi midis oligopolit dhe konkurrencës së plotë?

4. Çfarë thotë ligji i ofertës në lidhje me marrëdhënien midis çmimit dhe sasisë?

5. Cili është ndryshimi midis inflacionit dhe hiperinflacionit?

6. Çfarë lloj politikash ndërmarrin qeveritë për të mbrojtur një industri specifike të vendit?

7. Çfarë paraqet interesi i përbërë?

8. Një këshilltar financiar ofron të menaxhojë portofolin e investimeve të një klienti për një tarifë vjetore prej 1%. Klienti po shqyrton mundësinë e menaxhimit të investimeve të tij vetë për të shmangur pagesën e tarifës. Sipas konceptit të kostove të transaksionit, cilët janë faktorët kryesorë që klienti duhet të marrë në konsideratë kur merr këtë vendim?

9. Një politikëbërës qeveritar po shqyrton zbatimin e një programi subvencionesh për të mbështetur një industri në rënie me qëllim ruajtjen e vendeve të punës. Sipas konceptit "Vende pune kundrejt krijimit të pasurisë" në Ekonomiksin e Mendimit Praktik, cila është pasoja më e mundshme ekonomike afatgjatë e kësaj politike?


10. Çfarë paraqet Prodhimi I Brendshëm Bruto (PBB) në një ekonomi?

PJESA 3 – ANALIZË TË GRAFIKONIT (20 pikë)

Grafiku ilustron dy kurba të ofertës së punës. Njëra përfaqëson një sistem pagash fikse dhe tjetra përfaqëson një sistem pagash të bazuar në performancë. Boshti horizontal tregon përpjekjen e punës ose orët e punuara, dhe boshti vertikal tregon pagat ose shpërblimet.

Krahasoni dy kurbat dhe shpjegoni se si strukturat e ndryshme të nxitjes ndikojnë në sjelljen e punonjësve.

1. Pse oferta e punës është më e lartë sipas sistemit të pagave të bazuara në performancë? Shpjegoni përgjigjen tuaj duke përdorur informacionin e treguar në grafik.
2. Cilin parim ekonomik nga Ekonomia e Mendimit Praktik përfaqëson ky grafik?
3. Jepni një shembull nga jeta reale ku paga e bazuar në performancë mund të rrisë produktivitetin.



PJESA 4 – ESEJ (20 pikë)

Në qytetin e Nju Jorkut, çmimet e qirave u rritën me shpejtësi për shkak të rritjes së popullsisë dhe banesave të kufizuara. Për ta bërë banimin më të përballueshëm, qeveria lokale futi një ligj që i fikson çmimet e qirasë nën nivelin e tregut. Kjo masë u mirëprit nga shumë qiramarrës, veçanërisht familjet e reja dhe studentët.

Pas një viti, më pak apartamente ishin në dispozicion për qira. Disa pronarë ndaluan së mirëmbajturi ndërtesat e tyre, ndërsa të tjerë i shndërruan apartamentet me qira në zyra ose i shitën ato. Ndërtimi i ri i banesave me qira gjithashtu u ngadalësua sepse investitorët panë më pak fitim në ndërtimin e apartamenteve.

Si rezultat, gjetja e një apartamenti u bë më e vështirë, listat e pritjes u zgjatën dhe disa qiramarrës duhej të mbështeteshin në lidhjet personale në vend të listave të hapura për të gjetur strehim..

- **Shpegoni pse politika e kontrollit të qirasë çoi në më pak apartamente në dispozicion?**
- **Cilat pasoja të padëshiruara të kontrolleve të çmimeve shfaqen në këtë rast?**
- **Si do të mund qeveria lokale të luftojë këtë dukuri të re?**